



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 347/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos përputhjes së votave të rezultateve, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Hidhet e palejuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 11.06.2014, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR, në të cilën pretendohet se me rastin e publikimit të rezultateve preliminare nga KQZ-ja janë paraqitur 261 vota për subjektin politik LGTSH, ndërsa në formularët e nënshkruar nga anëtarët e KKZ-së nuk ka asnjë votë. Më tutje ka theksuar se i njejtë rezultat i prezantuar nga KQZ-ja është larguar nga faqja zyrtare e KQZ-së dhe tani janë 61 vota ku në formularë janë 0 vota. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se këto veprime të fryrjes së votave janë shqetësuese për subjektin politik AKR.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se :

ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet e subjektit politik AKR janë të pa lejuara në këtë fazë të procesit zgjedhor ngase ankimimi i rezultatit preliminar “K-Vote” të publikuar në vazhdimësi nga KQZ-ja është i pa ankimueshëm sepse ky rezultat është fleksibil dhe i ndryshueshëm në çdo moment. Prandaj duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 347/2014 më datën 12.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*